



BASHKIA
TIRANË

KRYETARI

URDHËR

Nr. 12683 / datë 25.4 2016

Për

“Krijimin e Shesheve Rekreative me Kënde Lojrash si dhe rikualifikimin e Këndeve ekzistuese të Lojrave”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1.1, shkronja “b” dhe “c”, pika 1.2, shkronja “a”, nenin 23, pika 9, nenin 25, pika 4, nenin 64, shkronja a, të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin 10296 dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin Nr. 30 dt. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Krijimin e shesheve rekreative me kënde lojrash, rikualifikimin e këndeve të lojrave ekzistuese në territorin e Bashkisë Tiranë.
2. Ngarkohet Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për konceptimin dhe projektimin e shesheve rekreative që përfshijnë kënde lojrash duke mbështetur me të gjithë logjistikën e nevojshme.
3. Ngarkohen Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit të mbështesin realizimin e shesheve rekreative, sipas fushës së kompetencës së tyre, nën koordinimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Projekteve Strategjike, Bashkia Tiranë.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike, Bashkia Tiranë, për koordinimin me marrëdhëniet me donatorët apo aktorë të ndryshëm.
5. Efektet financiare të pikës 3 të këtij urdhëri të mbulohen nga buxheti 2016 i drejtorive mbështetëse të përmendura më sipër.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme të Projekteve Strategjike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit dhe

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit dhe për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ERION VELIAJ

